



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 339/1 Prot

Tiranë, më 01.03.2021

V E N D I M

Nr.19, datë 01.03.2021

Mbi përfundimin e hetimit administrativ, me objekt verifikimin e ligjshmërisë së ankesës së nëpunësit ***, me objekt transferimin e përhershëm të tij, nga pozicioni “Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, në pozicionin “Specialist i Projekteve i Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale”, kategoria e pagës IV-a, për shkak të ristrukturimit të institucionit Këshilli i Qarkut Dibër.**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të nenit 90, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur dhe propozimit të paraqitur prej Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me verifikimin e ankesës së nëpunësit *****, për transferimin e paligjshëm të tij, për shkak të ristrukturimit të institucionit Këshilli i Qarkut Dibër,

VËREJ SE:

Nëpërmjet shkresës me nr. 906 prot., datë 04.12.2020, është protokolluar një kërkesë e nëpunësit *****, përmes së cilës ngrihen pretendime për shkelje të legjislacionit të shërbimit civil, në rastin e transferimit të përhershëm të tij, nga pozicioni “Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, në pozicionin “Specialist i Projekteve i Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale”, kategoria e pagës IV-a, për shkak të ristrukturimit të institucionit Këshilli i Qarkut Dibër dhe kërkohet ndërhyrja e Komisionerit për rivendosjen e ligjshmërisë, në përputhje me ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në fuqi.

Nga përmbajtja e ankesës rezulton se kërkuesi, me shkresën nr. 276 prot., datë 26.10.2020, me objekt: “Njoftim”, të njësisë përgjegjëse, është njoftuar për fillimin e procedurës së ristrukturimit të institucionit të Këshillit të Qarkut Dibër, procedurë e cila ka

përfunduar me Vendimin nr. 07, datë 23.11.2020, “Për transferimin e përhershëm të z. *****”, nëpërmjet të cilit nëpunësi *****, është transferuar nga pozicioni “Drejtor i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”, në pozicionin “Specialist i Projekteve i Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale”, pranë sektorit Juridik dhe Projekteve, duke pësuar ulje në kategorinë e pozicionit të punës dhe ulje në nivelin e pagës nga II-b në IV-a, duke mos respektuar kërkesat e nenit 50, “Transferimi në rastin e mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Në të njetën kohë, ankuesi parashton se janë liruar pa të drejtë nga detyra nëpunës, të cilët kishin mundësi të sistemoheshin në pozicione pune sipas strukturës së re, pasi duke karahasuar këtë strukturë me atë të mëparshmen, në Këshillin e Qarkut Dibër, nuk ka pasur ndryshim të numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pasi u njoh me pretendimet e parashtruara në ankesën e sipërpërmendur, me nr. 906 prot., datë 04.12.2020, me shkresën nr. 906/1 prot., datë 21.12.2020, me objekt: “Kërkesë për dokumentacion në lidhje me verifikimin e ankesës së nëpunësit *****”, kërkoi nga institucioni Këshilli i Qarkut Dibër, sqarime dhe dokumentacionin që materializon veprimet e kryera nga ana e institucionit, me këtë rast.

Në përgjigje të kësaj kërkesë, Këshilli i Qarkut Dibër, me shkresën nr. 344/1 prot., datë 28.12.2020, me objekt: “Kthim përgjigje shkresës tuaj me nr. 906/1 prot., datë 21.12.2020”, e protokolluar pranë Komisionerit me nr. 906/2 prot., datë 30.12.2020, ka paraqitur sqarimet si dhe dokumentacionin e kërkuar për rastin në fjalë. Gjithashtu, me e-mailin e datës 30.12.2020, punonjësi për menaxhimin e burimeve njerëzore në institucionin Këshilli i Qarkut Dibër, përcolli kopje të aktit nr. 307/2 prot., datë 01.12.2020, me anë të së cilit nëpunësi *****, ka njoftuar pranimin për tu transferuar në pozicionin “Specialist i Projekteve i Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale”, pranë Këshillit të Qarkut Dibër, duke përsëritur pretendimin se ky transferim bie ndesh me dispozitat e ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar dhe VKM-në nr. 125, datë 17.02.2016, “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.

Duke filluar analizën ligjore të këtij rasti, evidentojmë se, Këshilli i Qarkut Dibër si institucion i vetëqeverisjes vendore, vepron në ushtrim të kompetencave ligjore për përmbushjen e funksioneve të tij, bazuar në nenin 77, germa ç), e ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, ku ndër të tjera përcaktohet:

“...ç) miraton strukturën, organikën dhe kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së qarkut, të njësive e të institucioneve

buxhetore në varësi të qarkut, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikim, pagat dhe mënyrat e shpërblimit të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi...”.

Në relacionin që shoqëron propozimin për disa ndryshime në strukturën e Këshillit të Qarkut Dibër, është parashtruar se kohët e fundit, janë hasur vështirësi në përmbushjen e detyrave nga ana e administratës së këtij institucioni, për shkak të mungesës në strukturë të profesioneve si *“Jurist”* dhe *“Inxhinier”*, për këtë arsye është kërkuar riorganizimi i strukturës së institucionit, që brenda numrit ekzistues të nëpunësve, të ndërtohet një mekanizëm më i zhërvjelltë dhe efikas për arritjen e objektivave, duke shënuar në këtë mënyrë, përfshirjen e këtij institucioni në procesin e ristrukturimit.

Në vijim, ky propozim është miratuar me Vendimin nr. 17, datë 08.10.2020, të Këshillit të Qarkut Dibër, *“Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën organizative dhe nivelin të pagave të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër për vitin 2020”*.

Për këtë vendim, me shkresën nr. 261/2 prot., datë 15.10.2020, me objekt: *“Dërgim vendimi për verifikimin e ligjshmërisë”*, të Këshillit të Qarkut Dibër, është kërkuar verifikimi i ligjshmërisë nga ana e Prefektit të Qarkut Dibër, i cili me shkresën nr. 1579/1 prot., datë 20.10.2020, ka miratuar në parim këtë vendim, duke sjellë në vemendje të institucionit, këshillimin dhe bashkëpunimin me institucionet e DAP-it dhe KMSHC-së, për mënyrën e implementimit të strukturës së ndryshuar, në kuadër të ristrukturimit të institucionit të Këshillit të Qarkut Dibër.

Pasi është respektuar edhe kjo hallkë administrative, referuar pikës 15, të Vendimit nr. 125, datë 17.02.2016, të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”*, njësia përgjegjëse me anë të shkresës nr. 276 prot., datë 26.10.2020, ka njoftuar veç të tjerëve edhe nëpunësin *****, për fillimin e procedurës së transferimit apo përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të ristrukturimit të institucionit, i cili ka marrë dijeni dhe e ka sigluar shkresën e njoftimit në datë 27.10.2020, ora 14.20. Menjëherë pas kësaj, në mbështetje të pikës 5, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, me Vendimin nr. 4, datë 28.10.2020, (nr. 276/1 prot., datë 28.10.2020), *“Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit”*, të njësisë përgjegjëse, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit, me përbërje tre anëtarët: kryetar Fitim Farruku (*Përgjegjës i Sektorit të Financës*); anëtar Elisava Methasani (*Shefe Kabineti*); anëtar Fadil Shehi (*Drejtor i DAMT*).

Sa i takon përbërjes së këtij Komisioni, në Udhëzimin e DAP nr. 1, datë 01.03.2016, i ndryshuar, të cilit do ti referohemi për analogji, përcaktohet se anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit duhet të jenë nëpunës civilë, si rrjedhim përfshirja e punonjësve me funksion politik *“Shefe Kabineti”* si anëtare Komisioni është një aspekt kundërligjshmërie.

Por, duke mbajtur parasysh faktet që: a) Resurset njerëzore të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër janë tejet të kufizuara; Nëpunësi ******, si drejtues i njësisë së burimeve njerëzore, nuk mund të ishte pjesë e Komisionit të Ristrukturimit, për shkak se njësia dhe pozicioni i tij i mëparshëm i punës, prekej në mënyrë të drejtpërdrejtë nga procesi i restrukturimit; b) Komisioni i Ristrukturimit është organ kolegjal, që funksionon në bazë të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999, “*Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike*” dhe vendimmarrjen e tij e bën me shumicë votash, prandaj meqënëse, dy anëtarët e tjerë të këtij organizmi plotësojnë kushtet për të qenë në përbërje të tij sipas legjislacionit të shërbimit civil, pjesëmarrja e anëtares Elisava Methasani (*Shefe Kabineti*), në përbërje të këtij Komisioni, nuk prek vlefshmërinë e vendimarrjes së tij, për transferimin e punonjësit ******, pasi anëtarët e tjerë të Komisionit të Ristrukturimit kanë votuar, pa vërejtje, në favor të propozimit.

Më tej, Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në metodologjinë e vlerësimit dhe sistemin e pikëzimit, në krahasimin e strukturës së vjetër me strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 08.10.2020, pas verifikimit të përshkrimeve të punës dhe dosjeve personale të nëpunësve, në kushtet kur pozicioni i “*Drejtorit Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*” është suprimuar në këtë strukturë, me Vendimin nr. 03, datë 12.11.2020, ka propozuar transferimin e përhershëm të nëpunësit civil ******, në pozicionin “*Specialist i Projekteve i Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale*”, pranë Këshillit të Qarkut Dibër, propozim i cili është miratuar me Vendimin nr. 07, datë 23.11.2020, të njësisë përgjegjëse dhe drejtuesit të institucionit.

Ky vendim i është komunikuar me aktin nr. 307/2 prot., datë 01.12.2020, nëpunësit ******, i cili ka shprehur pranimin e transferimit në pozicionin “*Specialist i Projekteve i Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale*”, pranë Këshillit të Qarkut Dibër, deri sa të merreshin në shqyrtim pretendimet e tij, objekt i kësaj ankese.

Nga tërësia e rrethanave të evidentuara gjatë kryerjes së hetimit administrative të kësaj çështje, rezulton e vërtetuar se, në strukturën e re të miratuar me Vendimin nr. 17, datë 08.10.2020, “*Për miratimin e disa ndryshimeve në strukturën organizative dhe nivelit të pagave të administratës së Këshillit të Qarkut Dibër për vitin 2020*”, pozicioni i “*Drejtorit Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*” është suprimuar, pasi Këshilli i Qarkut Dibër, në mbështetje të kompetencës së tij lëndore të parashikuar në nenin 77, germa ç), e ligjit nr. 139/2015, “*Për vetëqeverisjen vendore*”, ka miratuar një strukturë organizative të shtrirë, të ndarë në sektorë, me varësi hierarkike direkt nga drejtuesi i institucionit.

Në këto kushte, punonjësi ******, i cili kishte mbajtur funksionin “*Drejtor Menaxhimit të Burimeve Njerëzore*”, me Vendimin nr. 07, datë 23.11.2020, të njësisë përgjegjëse dhe Kryetarit të institucionit, mbështetur në kriteret specifike të vendit të lirë të krijuar si pasojë e restrukturimit dhe të dhënave të nëpunësit civil, në pamundësi për tu sistemuar në një pozicion të të njejtës kategori, është transferuar në mënyrë të përhershme në pozicionin “*Specialist i Projekteve i Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale*”.

Nëpunësi *****, përmes shkresës me nr. 307/2 prot., datë 01.12.2020, për korrektesë administrative, ka pranuar të kalojë formalisht, në këtë pozicion pune, duke parashtruar njëkohësisht se, këtë e bën për të ruajtur marrëdhënien e tij me shërbimin civil, pasi aktet ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë institutin e transferimit të përhershëm në shërbimin civil, i japin të drejtë nëpunësit që transferohet, të refuzojë zbatimin e aktit vetëm në dy raste shteruese, sikurse janë distanca mbi 45 km dhe shkaqe të ndryshme shëndetësore. Këtë qëndrim ankuesi ***** e ka theksuar edhe në e-mailin e dërguar pranë KMSHC-së, më datë 21.01.2020, duke kërkuar njëkohësisht të veprohet sipas parashikimeve ligjore.

Duke analizuar gjendjen e fakteve si më sipër, bazuar në pikën 1, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se, nëse për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pozicioni i mëparshëm i një nëpunësi civil nuk ekziston më, ai transferohet në një pozicion tjetër të shërbimit civil të së njëjtës kategori, gjë që do të thotë se ai mund të transferohej për këtë shkak, vetëm në një pozicion të nivelit të mesëm drejtues.

Në rastin në shqyrtim, duke qenë se, në strukturën e re të institucionit të Këshillit të Qarkut Dibër, nuk ka pozicion të lirë të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues, (*me kategori të pagës II/b*) dhe nëpunësi në fjalë ka shprehur rezerva për transferimin në një pozicion dy shkallë kategorie më të ulët, atëherë Komisioni i Ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Dibër, duhej të propozonte si opsion, përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të tij, përmes liritimit nga shërbimi civil, në përputhje me pikën 1, germa a), e nenit 66, të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Gjithashtu, në mbështetje të nenit 50, pika 7, e ligjit 152/2013, i ndryshuar, nëpunësit *****, me largimin nga pozicioni i tij i mëparshëm i punës, për shkak të ristrukturimit të institucionit, duhej ti jepej një dëmshpërblim në përputhje me vjetërsinë e tij në shërbimin civil, sipas rasteve të parashikuar në këtë dispozitë, duke ruajtur statusin e nëpunësit civil, kategoria e mesme drejtuese në shërbimin civil, dhe konfirmimin e të drejtës që brenda një periudhe 2- vjeçare:

- a) të konkurrojnë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;
- b) të emërohet në mënyrë të përkohshme nga njësi përgjegjëse, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil.

Mosrespektimi i dispozitave ligjore si më sipër, bën që Vendimi nr. 07, datë 23.11.2020, "Për transferimin e përhershëm të *****", të nxjerrë nga njësi përgjegjëse dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut Dibër, bazuar në germën "d", të nenit 109, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", të jetë një akt i kundraligjshëm dhe si i tillë, në bazë të neneve 113 dhe 114, pika 1, të këtij ligji, duhet të ndryshohet me një akt të ri me shkrim, i cili ti japë zgjidhje ligjore mosmarrëveshjes së lindur, duke urdhëruar lirimimin e nëpunësit ***** nga shërbimi

civil për shkak të ristrukturimit dhe trajtimit të tij sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 50, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Sa i takon pretendimit tjetër të ankuesit, se gjatë kryerjes së procesit të ristrukturimit, janë larguar padrejtësisht disa punonjës, të cilët mund të sistemoheshin në institucionin e Këshillit të Qarkut Dibër, brenda strukturës së miratuar, pas verifikimit administrative rezulton se, sipas procesverbalit të Komisionit të Ristrukturimit protokolluar me nr. 276/2 prot., datë 12.11.2020, është propozuar përfundimi i marrëdhënies në shërbimin civil vetëm për një punonjëse, për shkak se nuk kishte mundësi transferimi në asnjë pozicion tjetër pune të të njejtës kategori, për shkak se, nuk plotësonte kriterin e llojit të arsimit, për atë pozicion.

Në përfundim, nga gjithë sa është parashtruar më sipër, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil arrin në konkluzionin se, për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, organi publik i cili ka nxjerrë aktin e mësipërm, bazuar në nenin 109, germa d), 113 dhe 114/1, të ligjit nr.44/2015, “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, duhet të konstatojë paligjshmërinë e tij, duke nxjerrë aktin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil përmes lirimit, siç u përmend në pjesën e sipërme arsyetuese të këtij vendimi.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 109, germa d), neni 113 dhe nenin 114/1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në mbështetje të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga organi publik, Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse e Këshillit të Qarkut Dibër, që pasi të konstatojnë paligjshmërinë e Vendimit nr. 07, datë 23.11.2020, “Për transferimin e përhershëm të *****”, ta anulojnë atë dhe pas kësaj të nxjerrin aktin e përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil, përmes lirimit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të institucionit për këtë punonjëse, duke i deklaruar në mënyrë të shprehur në këtë akt, të drejtat si më poshtë:
 - të drejtën e një dëmshpërblimi, në përputhje me vjetërsinë e tij në punë;
 - të drejtën që, brenda periudhës 2-vjeçare pas përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil:
 - a) të konkurrojë si nëpunës civil për procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë, sipas neneve 25 dhe 26 të këtij ligji;

- b) të emërohet në mënyrë të përkohshme nga njësia përgjegjëse, me pëlqimin e tij, në pozicione të shërbimit civil.
2. Për kryerjen e këtij veprimi administrativ, lihet afat **15 ditë**, nga marrja dijeni për këtë vendim.
 3. Me kalimin e këtij afati, të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
 4. Të njoftohet për këtë vendim institucioni Këshilli i Qarkut Dibër dhe nëpunësi *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha